



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

Përmbledhja e Aktgjykimit

(Vetëm për median. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A T

Hagë, 17 dhjetor 2008.

Përmbledhje e aktgjykimit në çështjen

Prokurori kundër Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës

Më poshte vijon përmbledhja e aktgjykimit shqiptuar sot prej Gjykatësit Orië:

Sot Dhoma Gjyqësore është mbledhur për shpalljen e Aktgjykimit në çështjen *Prokurori kundër Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*.

Në këtë seancë Dhoma Gjyqësore do të përmbledhë shkurtimisht historinë procedurale të çështjes, ligjin përkatës, disa parashtrime të palëve dhe përfundimet e Dhomës. Dëshirojmë të theksojmë se kjo nuk është veçse një përmbledhje dhe se versioni i vetëm autoritativ i përfundimeve të Dhomës është Aktgjykimi i cili do të jetë në disponim në fund të seancës.

Historia Procedurale dhe Aktakuza

Aktakuza kundër Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës u paraqit prej Zyrës së Prokurorit më 8 janar 2008 dhe u konfirmua më 12 shkurt 2008. Në aktakuzë deklarohet se në korrik dhe gusht 2007, të Akuzuarit me nismën e tyre ose me kërkesë prej të tjerëve nxitën ose kryen shpërfillje të Tribunalit duke ndërhyrë me vetëdije dhe qëllimisht në ushtrimin e drejtësisë nëpërmjet ndërhyrjes ndaj një dëshmitari të mbrojtur në çështjen *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*. Në këtë Aktgjykim, dëshmitari i mbrojtur do të quhet "Dëshmitari 2".

Në aktakuzë pretendohet se të Akuzuarit e dinin se Dëshmitari 2 ishte dëshmitar i rëndësishëm në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. Gjithashtu pretendohet se në fillim të korrikut 2007, Astrit Haraqija, Ministër i atëhershëm i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, udhëzoi Bajrush Morinën i cili e njihte Dëshmitarin 2, që të organizonte një takim për ta bindur Dëshmitarin 2 që të mos dëshmonte kundër Ramush Haradinajt. Aktakuza pohon se megjithëse fillimisht Astrit Haraqija planifikoi të udhëtonte me Bajrush Morinën për të takuar Dëshmitarin 2, përfundimisht vetëm Bajrush Morina u takua me të. Sipas Aktakuzës më 10 dhe 11 korrik 2007 Bajrush Morina pati dy takime me Dëshmitarin 2 që u incizuan prej policisë dhe gjatë të cilave Bajrush Morina ushtroi presion ndaj Dëshmitarit 2 që të mos dëshmonte kundër Ramush Haradinajt. Si zyrtar i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në atë kohë, Bajrush Morina kërkoi leje për udhëtimin e tij jashtë vendit. Sipas Aktakuzës, shpenzimet u paguan prej Ministrisë.

Bazuar në sa më sipër, Prokuroria ngarkon

Internet address: <http://www.un.org/icty>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

(1) **Astrit Haraqinë** me një akuzë për Shpërfilljen e Tribunalit, e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit ose, ndryshe, me një akuzë, Nxitje për Shpërfillje të Tribunalit e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) dhe (B) të Rregullores; dhe

(2) **Bajrush Morinën** me një akuzë për Shpërfillje të Tribunalit e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores.

Procesi gjyqësor u zhvillua prej 8 shtatorit 2008 deri më 11 shtator 2008. Gjatë procesit Dhoma Gjyqësore pranoi 39 prova materiale. Gjithashtu Dhoma mori dëshmi prej gjithsej 5 dëshmitarëve të Prokurorisë dhe 4 dëshmitarëve të Mbrojtjes së Haraqisë. Astrit Haraqija bëri një deklaratë në përputhje me Rregullën 84 *bis* dhe dëshmoi në cilësinë e dëshmitarit. Avokati i Bajrush Morinës nuk thirri dëshmitarë.

Ligji Përkatës

Tani do të trajtoj ligjin përkatës të vlefshëm për këtë çështje

Pavarësisht mospërmendjes së Shpërfilljes së Tribunalit në Statut, është vërtetuar tërësisht se Tribunali zotëron kompetencë të vetvetishme për procedimin penal dhe ndëshkimin e Shpërfilljes. Kjo kompetencë e vetvetishme buron prej autoritetit ligjor të Tribunalit për të mundësuar mospengimin e ushtrimit të juridiksionit të vet akorduar prej Statutit dhe garantimin e detyrave të veta themelore gjyqësore.

Të dy të Akuzuarit akuzohen në bazë të Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores. Kjo dispozitë përcakton se:

Në ushtrimin e kompetencës së vetvetishme Tribunali mund të shpallë fajtor për shpërfillje këdo që me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyt në ushtrimin e drejtësisë, përfshirë cilindo që:

(iv) kërcënon, frikëson, i shkakton lëndim ose i ofron shpërblim një dëshmitari ose ndryshe ndërhyt ndaj një dëshmitari i cili po dëshmon, ka dëshmuar ose do të dëshmojë në një proces të një Dhome Gjyqësore, ose ndaj një dëshmitari të mundshëm;

“Kërcënimi” përkufizohet si synim i shprehur për t’i shkakuar një dëm ose dëmtim të caktuar një dëshmitari dhe/ose pronës së dëshmitarit ose ndaj një personi të tretë dhe/ose pronës së tij, për të ndikuar ose nënshtruar vullnetin e dëshmitarit ndaj të cilit bëhet kërcënimi. “Frikësimi” konsiston në veprime ose mosveprime të fajshme që me gjasë përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë, të tërthortë ose të mundshëm ndaj dëshmitarit që mund të ndërhyjnë ose ndikojnë në dhënien e dëshmisë prej dëshmitarit. “Ndryshe ndërhyrje ndaj dëshmitarit” përfshin veprime ose mosveprime të ndryshme prej kërcënimit, frikësimit, lëndimit ose ofrimit të shpërblimit, të cilat janë në gjendje dhe kanë gjasë ta parandalojnë dëshmitarin për dhënien e një dëshmie të plotë dhe të besueshme ose që ndikojnë karakterin e dëshmisë në ndonjë mënyrë tjetër. Individit që ndryshe ndërhyt ndaj dëshmitarit duhet të ketë vepruar qëllimisht me dijeninë se sjellja e tij me gjasë do ta parandalonte ose ndikonte dëshmitarin.

Ndryshe, Astrit Haraqija akuzohet edhe për Nxitje për Shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77(B) të Rregullores, sipas së cilës çdo person që me vetëdije dhe qëllimisht inkurajon dhe/ose bind një person tjetër që të kryejë çfarëdo veprimi të përshkruar në Rregullën 77(A) të Rregullores, përballet me të njëjtat dënime si kryesi.

Kushti i Konfirmimit

Tani vijmë në pikën e ngritur prej Mbrojtjes së Haraqisë nëse provat në lidhje me veprimet dhe sjelljen e Astrit Haraqisë që përfshihen në intervistën e Bajrush Morinës në cilësinë si i dyshuar e cila u pranua si provë, kanë nevojë për konfirmim, dhe nëse është kështu, nëse dëshmia konfirmuese mund të vijë prej të njëjtit dëshmitar. Nëqoftëse përgjigjja për të dy pyetjet është pohuese, Dhoma Gjyqësore duhet të shqyrtojë edhe deri në çfarë mase mund të lejohet që përfundimet e Dhomës Gjyqësore të nxirren mbi bazën e një deklaratë që nuk iu nënshtrua pyetjeve nga pala kundërshtarë.

Dhoma e Apelit ka konfirmuar parimin se shpallja e fajësisë bazuar tërësisht ose kryesisht në deponimin e një dëshmitari, të cilin i akuzuari nuk ka patur mundësi ta pyesë qoftë gjatë hetimit apo gjatë procesit gjyqësor, përbën një shkelje të papranueshme të së drejtës së të akuzuarit për një proces gjyqësor të drejtë. E drejta për të pyetur dëshmitarët gjen zbatim në deponimet e dhëna kundër të akuzuarit prej dëshmitarëve të rregullt dhe të bashkakuzuarit. Rrjedhimisht dëshmia e një dëshmitari i cili nuk është pyetur nga pala kundërshtarë, ka nevojë për konfirmim të mjaftueshëm prej provave të rëndësishme, nëqoftëse ky deponim do të shfrytëzohet për shpalljen e fajësisë.

Duke qenë se në Rregullore dhe në jurisprudencën e Tribunalit mungojnë shembuj të trajtimit të kushteve të provave konfirmuese, Dhoma Gjyqësore analizoi qasjet e adoptuara në gjyqësorët e disa shteteve. Meqenëse Dhoma Gjyqësore nuk u nënshtrohet rregullave të shteteve në lidhje me provat konfirmuese, ajo e bëri këtë analizë vetëm për ta patur si udhëzues.

Prej analizës që mund të lexohet në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se, megjithëse prej disa sistemeve gjyqësore kërkohet që dëshmia duhet të vijë prej një burimi të pavarur dhe të veçantë që të përdoret si dëshmi konfirmuese, të tjerë adoptojnë një qasje jo kaq teknike dhe kërkojnë vetëm që dëshmia konfirmuese të përcaktojë lidhjen midis të akuzuarit dhe kryerjes së krimit dhe jo domosdoshmërisht të vijë prej një burimi tjetër.

Duke qenë e vetëdijshme në detyrën e saj për zbatimin e atyre rregullave për provat që ndihmojnë më së miri në marrjen e një vendimi të drejtë të çështjes në fjalë dhe përputhen me frymën e Statutit dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, Dhoma Gjyqësore konkludoi se që një dëshmi të mund të konfirmojë dëshmi të paverifikuara nga pala kundërshtarë, ajo jo vetëm që duhet të përçojë një përshtypje të fortë vërtetësie të dëshmisë së paverifikuar, me fjalë të tjera të shtojë vlerën e saj provuese, por gjithashtu duhet të merret në mënyrë të pavarur. Duke mos adoptuar një qasje teknike ndaj kësaj çështjeje, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në provat konfirmuese mund të përfshihen edhe ato prova që megjithëse kanë të njëjtin burim, dolën në rrethana të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme. Prova të tilla janë me të vërtetë konfirmuese në masë të mjaftueshme duke synuar parandalimin e shkeljes së të drejtave të të akuzuarit.

Përgjegjësia e Bajrush Morinës

Tani do të përmend përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë e Bajrush Morinës.

Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi që vërtetonin se më 2 korrik 2007 Bajrush Morina kontaktoi Dëshmitarin 2 dhe më pas udhëtoi dhe u takua me të më 10 dhe 11 korrik. Gjatë takimeve Bajrush Morina i tha Dëshmitarit 2 se ishte dërguar prej Astrit Haraqisë që, për të shpëtuar Ramush Haradinajn, t'i kërkonte Dëshmitarit 2 të mos dëshmonte kundër Haradinajt. Gjithashtu Bajrush Morina i tha Dëshmitarit 2 se dëshmitarë të tjerë që kishin dëshmuar në Tribunal për çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, ishin vrarë më pas.

Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat treguan në mënyrë përputhëse që Bajrush Morina dinte se Dëshmitari 2 do të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. Dhoma Gjyqësore e hodhi poshtë argumentin e Mbrojtjes se Prokuroria nuk mundi të vërtetojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kishte të ngjarë që sjellja e Bajrush Morinës ta bindte Dëshmitarin 2 që të mos dëshmonte. Megjithëse sjellja e Bajrush Morinës ishte në formën e këshillave miqësore dhe ndodhi në një atmosferë miqësore, ishte e qartë se fjalët e Bajrush Morinës synonin dhe mund të interpretoheshin vetëm si thirrje e vendosur dhe pa mëdyshje ndaj Dëshmitarit 2 që të mos dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. Dhoma Gjyqësore mendon se një sjellje e tillë përbënte frikësim, që është ndërhyrje e llojit të përshkruar prej Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores. Dështimi i Bajrush Morinës për ta bindur Dëshmitarin 2 që të mos dëshmonte, nuk është thelbësor në përcaktimin e përgjegjesisë së tij.

Po ashtu, mungesa e motivit që u pretendua prej Mbrojtjes, nuk mund të kishte ndikim mbi këtë çështje. Ashtu si ekzistenca e një motivi për kryerjen e krimit, në vetvete ka pak ose aspak vlerë provuese nëse i akuzuari e kreu krimin, po ashtu mungesa e motivit nuk mund të përgënjeshtrojë fakte të vërtetuara nëpërmjet provave të besueshme. Gjithsesi mungesa e motivit mund të bëjë të nevojshme verifikimin e mëtejshëm të bindshmërisë së provave para se të përcaktohet se u krye krim, dhe se ishte i akuzuari ai që e kreu. Mirëpo në çështjen në fjalë, provat ishin të qarta dhe bindëse.

Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se sjellja e Bajrush Morinës përbën Shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores.

Përgjegjësia e Astrit Haraqisë

Tani u vjen radha përfundimeve të Dhomës Gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë e Astrit Haraqisë.

Së pari Dhoma Gjyqësore trajtoi parashtrimin e Prokurorisë se më 2 korrik 2007 Astrit Haraqija takoi Bajrush Morinën në një veprimtari kulturore në Pejë dhe e udhëzoi të organizonte një takim me Dëshmitarin 2. Megjithëse dëshmia nuk ishte vendimtare, Dhoma Gjyqësore konkludoi se data dhe vendi i një bisede të tillë nuk janë thelbësore për përgjegjësinë e Astrit Haraqisë dhe më pas iu kthye çështjes nëse ishte vërtetuar se Astrit Haraqija kishte udhëzuar Bajrush Morinën që të ndërhynte ndaj Dëshmitarit 2.

Dhoma Gjyqësore kujtoi përfundimin e saj se sjellja e Bajrush Morinës përbënte Shpërfillje të Tribunalit. Megjithëse implikimi i Astrit Haraqisë buron pak a shumë prej Intervistës së Bajrush Morinës në cilësinë si i Dyshuar dhe Përgjimët e Incizuara të takimeve midis Bajrush Morinës dhe Dëshmitarit 2, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ky implikim vërtetohet edhe prej tërësisë së provave. Dhoma Gjyqësore ishte e vetëdijshme se shumë prej provave në fund të fundit erdhën prej Bajrush Morinës. Mirëpo Dhoma Gjyqësore i konsideroi si të pavarura prej Intervistës me të Dyshuarin, si edhe të pavarura prej njëra-tjetrës, meqenëse ato dolën në rrethana të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, siç shpjegohet hollësisht në Aktgjykim.

Veç gjykimit të kategorive të ndryshme të provave si mjaftueshmërisht të pavaruara ndaj njëra-tjetrës dhe si pasojë, të afta për konfirmimin e Intervistës me të Dyshuarin, Dhoma Gjyqësore konstatoi edhe një përputhje në një masë të madhe të krejt provave në lidhje me implikimin e Astrit Haraqisë. Për më tepër Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat eliminuan skenarin alternativ sipas të cilit Bajrush Morina do ta kishte implikuar Astrit Haraqinë në çdo rrethanë dhe në çdo moment kur dilnin prova inkriminuese. Gjithashtu ditari i Astrit Haraqisë dhe planet e tjera të tij të udhëtimit nuk binin ndesh me provat në lidhje me implikimin e Astrit Haraqisë, duke qenë se ato nuk përmendin plane për datat përkatëse, që do të mund të krijonin dyshim të arsyeshëm në lidhje me pjesëmarrjen e Astrit Haraqisë.

Së fundi, hamendësimet e një motivi alternativ të Bajrush Morinës për takimet me Dëshmitarin 2 për të ndërhyrë ndaj dëshmisë së tij, gjithashtu nuk krijuan dyshim të arsyeshëm në lidhje me përgjegjësinë e Astrit Haraqisë. Dhoma Gjyqësore konkludoi se duke marrë parasysh rrethanat personale dhe financiare të Bajrush Morinës, thuhet nuk ka të ngjarë që ai të ketë udhëtuar me iniciativën e vetë. Nga ana tjetër, Astrit Haraqija ishte angazhuar në mbrojtjen e Ramush Haradinajt në kontekst të pozitës së tij politike brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës ("LDK") dhe qeverisë së koalicionit nën udhëheqjen e Haradinajt. Për më tepër Astrit Haraqija kishte shprehur vazhdimisht pakënaqësi dhe mospajtim në lidhje me proceset gjyqësore të Tribunalit kundër kosovarëve si Ramush Haradinaj.

Si përfundim Dhoma Gjyqësore u bind se i vetmi deduksion i logjikshëm që mund të nxirrej prej provave në tërësi duke marrë parasysh lidhjet e dyanshme konfirmuese dhe tërësinë e rrethanave, është se Astrit Haraqija dinte se Dëshmitari 2 ishte dëshmitar në procesin *Haradinaj dhe të tjerë* në Tribunal dhe udhëzoi Bajrush Morinën të kontaktonte Dëshmitarin 2 me detyrë konkrete që të ndërhynte ndaj dëshmisë së tij.

Megjithëse Astrit Haraqija nuk e takoi vetë Dëshmitarin 2 ose nuk ishte në kontakt me të, Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se duke ditur se Dëshmitari 2 do të dëshmonte në Tribunal, Astrit Haraqija ushtroi ndikimin e tij mbi Bajrush Morinën i cili e pranoi eproritetin e Astrit Haraqisë dhe zbatoi udhëzimet e tij. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se sjellja e Astrit Haraqisë ishte pjesë përbërëse e sjelljes kriminale të Bajrush Morinës dhe për pasojë përbën Shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores.

Dënimi

Tani do të paraqes vlerësimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me dënimin që do të jepet.

Në lidhje me të dy të Akuzuarit Dhoma Gjyqësore theksoi se midis mënyrave të mundshme të ndërhyrjes ndaj ushtrimit të drejtësisë, frikësimi i dëshmitarëve është veçanërisht i rëndë. Në këtë vlerësim u mor parasysh edhe rëndësia e garantimit të ushtrimit të përshtatshëm të drejtësisë në procese gjyqësore të Tribunalit duke i mbrojtur dëshmitarët prej ndërhyrjeve. Rrjedhimisht ajo nuk e konsideroi si rrethanë rënduese gjendjen e veçantë me të cilën u përball Dhoma Gjyqësore në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* në marrjen e dëshmimeve prej dëshmitarëve në rrethana të konsideruara të sigurta prej dëshmitarëve.

Dhoma Gjyqësore konsideroi rrethanë rënduese faktin se Astrit Haraqija keqpërdori pozitën e tij të lartë në qeveri për të ushtruar presion ndaj një nëpunësi të ministrisë së tij.

Si rrethana lehtësuese për Bajrush Morinën, Dhoma Gjyqësore konsideroi karakterin e tij të mirë, mungesën e precedentëve penalë dhe gjendjen e tij familjare. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se për kryerjen e Shpërfilljes së Tribunalit, Astrit Haraqija ushtroi presion ndaj Bajrush Morinës dhe se Bajrush Morina nuk kishte dëshirë të zbatonte çfarë i kërkoi Astrit Haraqija dhe i kërkoi ndjesë Dëshmitarit 2 për sjelljen e vetë.

Si rrethana lehtësuese për Astrit Haraqinë, Dhoma Gjyqësore mori parasysh, karakterin e tij të mirë dhe pjesëmarrjen e tij në nisma politike përfshirëse dhe pajtuese si dhe gjendjen e tij familjare.

Vendim

Tani do të lexoj pjesën përkatëse të Vendimit të Aktgjykimit. Z. Haraqija, Z. Morina, ju lutem ngrihuni.

Bazuar në Statutin e Tribunalit dhe Rregullat 77 dhe 77 *bis* të Rregullores:

I Akuzuari Astrit Haraqija është **fajtor** për Shpërfillje të Tribunalit (Pika 1), e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) dhe Rregullës 77 (G) të Rregullores;

Astrit Haraqija dënohet me një dënim të vetëm prej pesë (5) muajsh burgim. Astrit Haraqija ka kaluar 36 ditë në paraburgim. Bazuar në Nenin 101(C) të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim t'i zbritet prej kohëzgjatjes së dënimit.

I Akuzuari Bajrush Morina është **fajtor** për Shpërfillje të Tribunalit (Pika 1), e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) dhe Rregullës 77 (G) të Rregullores.

Bajrush Morina dënohet me një dënim të vetëm prej tre (tre) muajsh burgim. Bajrush Morina ka kaluar 36 ditë në paraburgim. Bazuar në Nenin 101(C) të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim t'i zbritet prej kohëzgjatjes së dënimit.

Sekretari të marrë masa për zbatimin e dënimit.

Këtu përfundon shpallja e Aktgjykimit që tani do të jetë publikisht në disponim. Seanca mbyllet.
